

Kapitull i veçantë dhe me interes i këtij bleni është ai i „Këngëve kreshnike”, ku autori ka përfshirë materiale ndër më të mirat që janë botuar gjer tani — gjithsejt 21 këngë, për të cilat bën fjalë gjerësisht në parathënie. Demush Shala konsideron se këto këngë janë shumë të vjetra dhe ndofta i takojnë periudhës iliro-thrake. Pa dashur të hyjmë në çështjen e gjenezës së këtyre këngëve, respektivisht hipotezës që shtron ai, po theksojmë se këto këngë, me karakteristikat e veçanta, paraqesin një kualitet e vlerë të pamohueshme artistike të letërsisë sonë gojore përgjithësisht, qoftë për fjalët e shprehjet e pasura, për tropet dhe figurat e shumta, qoftë për fuqinë narrative në përshkrimin e epizodeve të ndryshme. Në fund të vëllimit autori ka futur dhe „Këngët mbi Gjergj Elez Alinë” (një këngë dhe një variante). Padyshim që është çështje në vete se a kanë këto dy këngë karakteristikat specifike që të meritojnë të botohen kështu të veçuara. Sidoqoftë, kënga e Gjergj Elez Alisë është një ndër krijimet më të bukura të letërsisë sonë gojore.

Sikurse çdo botimi të tillë, edhe këtij bleni të Demush Shalës mund t'i bëhen disa vërejtje, të cilat ai duhet t'i ketë parasysh me rastin e ribotimit. Fitohet përshtypja se autori, duke synuar të përfshijë shtrirjen gjeografike sa më të gjerë të këngëve, nuk ka arritur kurdoherë t'i mbetet besnik parimit që ka përmendur në fillim — të botojë vlerat më të mira nga këto lloje këngësh. Çështje më vete është terminologjia. Shpesh bëhet identifikimi: Legjendë-baladë, legjendë-romansë, legjendë-këngë kreshnike etj. Termi folkloristika ka një

kuptim të gjerë dhe nuk është përdorur përherë me vend. Kur flitet për krijimet e letërsisë gojore, ky term duhet të përdoret në raste specifike. Për letërsinë e shkruar autori përdor termin *letërsi e kultivuar* apo *artistike*, edhe pse shpeshherë flet për vlerat e mëdha artistike të letërsisë gojore dhe për kultivimin e saj gojë me gojë e brez pas brezi, me shekuj. Gjithashtu ai përdor termin *letërsi popullore*, herë gojore, traditë popullore e herë-herë folklor e folkloristike (këtë të fundit e përdor në dy kuptime: herë si lëndë e herë si mënyrë, metodë interpretimi a studimi të kësaj lënde).

Me rastin e ribotimit duhet të futen sa më pak motërzime dhe të kihet parasysh niveli i tyre artistik. Duhet poashtu të evitohen disa gabime teknike (në fjalor) e të shënohen dhe disa fjalë të huaja (si *uvladin*, *puste*, *novinar* etj.). Të shkruhet drejt emri i mbledhësit dhe studjuesit të zellshëm të letërsisë sonë gojore Qemal Haxhihasanit (në të gjitha rastet) e jo Qamil. Të përmirësohet data e botimit të *Rapsodive të De Radës* (1866) e jo sikur ka dalur (1868), të shënohen drejt disa tituj të veprave në bibliografi etj.

Sidoqoftë, përkundër këtyre lëshimeve që janë ndofta dhe rezultat i natyrës komplekse të hartimit të vëllimeve të këtilla, *Këngët popullore legjendare*, përpiluar nga Demush Shala, të prira nga një parathënie e gjatë shkruar nga autori, është ble i çmueshëm, që u mirëprit nga shumë lexues, nxënës e studentë. Ai plotësoi një zbrast të madhe që ndihej për këngët popullore epike në Kosovë, jo më pak se 20 vite.

ANTON BERISHA

Demush Shala: KËNGË POPULLORE LIRIKE, botoi Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1972, 8^o f. 291.

Bleni KËNGË POPULLORE LIRIKE, hartuar nga Demush Shala, përfshin thuajse të gjitha format e lirikës sonë gojore. Materiali është i ndarë në nëntë kapituj. Librit i prin një parathënie, ku në mënyrë kronologji-

ke bëhet fjalë për disa nga veçoritë e këtyre llojeve të krijimtarisë sonë poetike gojore. Vëllimi është i pasur si për kah tematika, ashtu dhe për kah vlerat letrare-artistike. Për hartimin e tij Demush Shala ka shfrytë-

zuar botimet e letërsisë gojore që kanë parë dritën në Tiranë, në Prishtinë, në revistat që janë botuar para luftës, në Jetën e re, Jehonën, në punimet e seminareve të studentëve të SHLP të Prishtinës, në dorëshkrime autorësh etj.

Pasi thekson rolin dhe rëndësinë e këngëve dhe të këngëtarëve popullorë, të cilët i hartuan dhe i ruajtën brez pas brezi këto krijime poetike gojore, autori vë në dukje se „këngët lirike shqipe, sidomos ato të riteve të lindjes, të motmotit dhe të vdekjes janë mjaft të vjetra”. Duke bërë fjalë për disa elemente të përbashkëta që kanë këto lloje të poezisë gojore, në vijim D. Shala jep një pasqyrë (kronologjike) të materialeve të botuara të lirikës gojore që nga Dorëshkrimi i Kieutit (1737) e deri te botimet më të reja që janë bërë në Tiranë dhe në Prishtinë. Edhe vetë autori thekson se kjo punë duhet të merret si përpjekje për një bibliografi më komplete të blejve dhe të materialeve të botuara të kësaj gjinie të krijimtarisë gojore shqipe.

Në kapitullin e parë të këtij bleni autori me të drejtë ka futur *Këngët e lindjes dhe nina-nanat*. Edhe pse të kufizuara në numër, të parat janë me interes, sepse pasqyrojnë një moment të rëndësishëm të jetës; gezimin e anëtarëve të familjes për trashëgimtarët e rinj, sidomos kur lind djalë. Këngët e djepit pasqyrojnë një gjendje interesante psikike të nënave e motrave, të cilat duke i përkundur fëmijët, shprehin në këngët e tyre urimet e ndryshme për të ardhmen e foshnjeve. Nga disa këngë vërejmë evoluimin e dëshirave të nënave e të motrave, çka dëshmon se këto krijime poetike përcjellin ndërrimet dhe synimet shoqërore të kohës. Nëna sot dëshiron që i biri apo e bija të bëhet shkollar i mirë, mjek, profesor etj. Pos kuantitetit, këtë cikël këngësh e karakterizon dhe vargu i gdhendur me një ritëm të ngadalësuar. Prej tropeve e figurave stilistike dallojmë, sidomos, krahasimin dhe epitetin.

Edhe *Këngët për fëmijë* janë zgjedhur me kujdes. Ato pasqyrojnë botën e fëmijëve, interesin e tyre për njerëz, kafshë, shpendë dhe për objekte të ndryshme që i rrethojnë. Kë-

to këngë, paraqiten me një gjuhë mjaft përgdhelëse dhe kanë një ritëm të zhdërvjellët.

Në *Këngët e dashurisë* na tërheqin vërejtjen cilësitë artistike dhe shtrirja gjeografike e tyre. Ato pasqyrojnë dëshirat e djemve ndaj vashave dhe anasjelltas. Ndjenjat suptile shprehen kurdoherë me një ngrohtësi e sinqeritet e herë-herë dhe me një erotizëm të haptë. Këngët e dashurisë, pos të tjerash, pasqyrojnë gjendjen psikologjike të të rinjve, japin disa të dhëna rreth vendit të takimeve dashurore dhe ca episode dashurie. Shumica e këtyre krijimeve poetike kanë një vlerë të konsiderueshme artistike. Për bukurinë e tyre mund të dallojmë: „Ka p'e nisen grigjen sot” „Mori e mira n'dyshekllak” „S'ma ki shoqen n'shtat mahallë”, „Unë jaranin ta kam marrë”, „Moj e Mira synin si rrushi”, „E let, letëza vashë”, „Lëngimi i dashurisë”.

Meqenëse këngët lirike të arbëreshëve të Italisë janë të një niveli më të lartë artistik, autori është dashur të përfshijë një numër sa më të madh sosh.

Kapitulli më voluminoz është ai me „*Këngë dhe valle të dasmës*”, të cilin D. Shala e ka ndarë në 23 nënkapituj, duke përfshirë në kuadrin e tyre dhe këngë të martesës së pafat dhe „*Dasma të shqiptarët e Italisë*” (177 këngë). Në të është përfshirë një material me të vërtetë i pasur dhe i llojllojshëm. Ndarja në nëngrupe e këngëve është bërë kryesisht në bazë të fazave të zhvillimit të dasmës. Në fillim janë përfshirë këngët e parafesës, të mësitit, të fejesës, të nishanit, të dhuntisë. Këngët e kanagjeçit nisin me „*Këngë për të vuarit e kënasë nuses në shtëpi të vet*” dhe vazhdojnë me momente të tjera, që pasqyrojnë këto këngë sipas zhvillimit të kësaj ngjarjeje të rëndësishme të jetës familjare. Këngët që këndohen në shtëpi të dhëndërit, autori i nis me *Këngë të gjuajturit e lules dhe i mbyll me ato kur shkon nusja te prindërit e vet për herë të parë*. Në kapitullin „*Këngë dhe valle të dasmës*”, D. Shala ka përfshirë dhe *Këngë të martesës së pafat dhe të Dasmës së shqiptarëve të Italisë*. Të parat, mendoj, nuk i takojnë këtij cikli. Ato i takojnë grupit të këngëve — të tjera, të ndry-

shme apo është dashur të ndahen si të veçanta, sepse ato nuk këndohen në dasmë. Ndërsa këngët e arbëreshëve të Italisë nuk është dashur të ndahen veç. Ato kanë tiparet dhe cilësitë e këngëve të tjera të dasmës shqiptare.

Me interes janë „Këngët e festave periodike dhe të muajve si dhe Këngët e punës”. Edhe pse në numër të kufizuar, ato tërheqin vëmendjen për tematikën e tyre, për dëshirat e një-rëzve për dukuritë e ndryshme për të cilat ka qenë e lidhur ngushtë jeta e tyre. Ndofta këngët e motmotit është dashur të ndahen sipas festave kur ato këndohen. Këngët e punës faktëqësisht janë tejet të kufizuara (vetëm 4 këngë nga Kosova) dhe nuk kanë ndonjë vlerë të dalluar letrare-artistike.

„Këngët e kapuçave dhe të filxhanave”, të cilat i karakterizon një notë e theksuar humori dhe satire janë mjaft të plota dhe të zgjedhura me kujdes. Pjesa më e madhe e tyre botohen për herë të parë (vetëm katër sosh janë marrë nga botimet e mëparshme).

Në „Këngë të mërgimit dhe të kurbetit” janë përfshirë 30 krijime të këtilla poetike nga treva të ndryshme. Kryesisht janë këngë të vjetra që pasqyrojnë jetën e popullit tonë nën zgjedhën turke, kohë kur njerëzit e shtresave të varfëra ishin të detyruar të lënë vatrat dhe të shkojnë në vende të tjera të largëta për të fituar kafshatën e bukës. janë përfshirë dhe disa këngë të reja të kurbetit. Një kapitull mjaft me interes është „Vajet dhe këngët e përvajshme”, ku autori ka përfshirë disa nga vajtimet më të

fuqishme që janë botuar gjer më sot. Dallohen vajet nga Gusia e sidomos bie në sy vajtimi „Ku a kenë mirë me ndjellun zi, hej hej...”, që padyshin është ndër krijimet më të fuqishme artistike të këtij lloji të krijimtarisë sonë letrare gojore. Janë botuar 24 vajtime e këngë të përvajshme, material ky mjaft i pasur.

Bleni *Këngë popullore lirike* është i përcjellë me aparaturën e nevojshme: fjalori, burimet e lëndës dhe literatura.

Përkundër vlerës së pamohueshme të vëllimit, atij mund t'i bëhen disa vërejtje të përgjithshme dhe të veçanta: duhet të rishikohen disa nga periudhat e gjata të parathënies, që nuk janë të përshtatshme për nxënës e studentë të shkruhen drejt disa vargje që nuk janë në pajtim me mënyrën e të kënduarit (Lumja shpia qi të ka marrë, /se kshtu të mirë s'tkena pritë;/ /T'përkundi në hije t'sanës;/ ka n'drum s'kemi plaçkitë, /se të ka nana për hasret e disa vargje të tjera), të hiqen disa këngë që nuk kanë ndonjë vlerë, qoftë letrare, qoftë tematike si psh. nga ato të dashurisë (62, 66), të dasmës (171 etj.). Disa këngë që nuk janë të kënasë, të qiten në vendin ku duhet. Klasifikimi lypset të jetë sa më i afërt dhe analogjik (sidomos për këngët e dasmës — këngë dasme në shtëpinë e dhëndërit, këngë dasme në shtëpinë e vajzës); kënga nr. 38 e „Këngë dasme” është dashurie, ajo nr. 172 nuk është e martesës së pafat, por e fejesës së pafat etj. Me rastin e ribotimit duhet të merren parasysh vetëm këngët dhe variantet që kanë vlerë të dukshme tematike e letrare dhe të evitohen gabime jo të vogla me karakter teknik.

ANTON BERISHA

